REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:046891

Datë: 31.03.2021

Numri i dokumentit: 01653752

P.nr.116/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit B. F. me vendbanim në Vushtrri, rr "B. K.", për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 ne lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.163/21 e datës 02.03.2021, më datë **17.03.2021** përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP-II.nr.163/21 e datës 02.03.2021, andaj gjykata konfrom dizpozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: B. F., nga i ati T. i lindur më datë ..., me adresë në Vushtrri, rr "B. K.", me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 04.12.2020, rreth orës 20:00, tek rreth rrotullimi në fshatin G.-Vushtrri, me rastin e kontrollit njësia e DHTN-se, pa autorizim ka poseduar drogën narkotike, dhe ate dy cigare marihuane, ne sasi totale prej 0.61=o.0001 gram, e përzier me tetrahidrokanabinol (THC), te cilën e ka blere nga një person i panjohur ne fshatin Maxhuni-Vushtrri, për nevoja personale, e cila me këtë rast iu është konfiskuar (marr) nga ana e Policisë, pra në mënyrë të paautorizuar ka poseduar drogë.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 ne lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së.**
-

Andaj, gjykata konformë dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21,38, 40, 43, 69 dhe nenit 269 të KPRK-ës, si dhe nenit 450 dhe 495 të KPPK-ës,

GJ Y K ON

2021:046892

DËNIM ME GJOBË në shumën prej pesëqind euro (500 €), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20€ (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1(një) ditë burgim.

Me DËNIM PLOTËSUES konfiskimi i përhershëm sendeve dhe atë, e llojit Marihuanë, në peshë prej ne sasi totale prej 0.61=o.0001 gram e cila i është sekuestruar, detyrohet Policia e Kosovës, për asgjësimin e sajë në pajtim me legjislacionin përkatës.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.163/21 e datës 02.03.2021, ndaj të pandehurit B. F. me vendbanim në Vushtrri, rruga "B. K.", për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 ne lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri B.F., ligjvënësi ka parashkruar dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konfrom nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konfrom dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dizpozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Raporti i Oficierit 2020-BD-835 i dt. 11.12.2020, në të cilin raport është raportuar se i pandehuri B.F. gjatë kontrollës, kishte poseduar substanca narkotike ne veture, Vërtetim mbi sekuestrimin përkohësisht të sendeve të dyshuara, i datës 04.12.2020, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dyshuarit B. F. i datës 04.12.2020, raporti i këqyrjes së vendit te ngjarjes i datës 04.12.2020, fotoalbumi i datës 04.12.2020, njesia e forenzikës e datës 04.12.2020, raporti i ekspertimit i datës 05.02.2021,te gjitha këto janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave

2021:046892

psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 ne lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqipton urdhërin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata morri parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-ës, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.116/21, datë: 17.03.2021

Procesmbajtësja **GJYQTARI**
Bahrije Smakolli **Agron Maxhuni**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.

2021:046892